



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-04

Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës

Vendosi: Trupi Gjykses I

Gjykatëse Mapi Feld-Folia, Kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 15 maj 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Urdhri i Dytë për Parashtrime në lidhje me Heqjen e Redaktimeve dhe/ose
Riklasifikimin e Transkripteve të Seancave Gjyqësore**

**Ushtruesit të Detyrës së Prokurorit të
Specializuar**
Aleks Uajting

Mbrojtjes së të akuzuarit
Zhan-Lui Zhilisen

Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz

TRUPI GJYKUES I (Trupi Gjykues) nxjerr këtë urdhër për parashtrime lidhur me heqjen e redaktimeve dhe/ose riklasifikimin e transkripteve të seancave gjyqësore.

1. Më 4 prill 2023, Trupi Gjykues urdhëroi palët dhe Mbrojtësin e Viktimave të rishikonin transkriptet e seancave gjyqësore që lidheshin me bllokun e parë të dëshmive dhe të paraqitin parashtrime lidhur me mundësinë e heqjes së redaktimeve ekzistuese dhe/ose mundësinë e riklasifikimit të transkripteve si publike.¹
2. Nga 1 deri më 3 maj 2023, Trupi Gjykues dëgjoi dëshmitë e dëshmitarëve TW4-10 dhe TW4-11, si pjesë e bllokut të dytë të dëshmive.²
3. Trupi Gjykues u referohet neneve 21(2), 23, dhe 40(2), (4) dhe (6)(f) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji) dhe rregullave 80 dhe 84(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (Rregullorja).
4. Trupi Gjykues rikujton se, në bazë të nenit 21(2) të Ligjit dhe në varësi të masave mbrojtëse për dëshmitarët dhe viktimat të urdhëruara në bazë të nenit 23 të Ligjit, i akuzuari ka të drejtë për seancë publike në përcaktimin e akuzave kundër tij.
5. Me qëllim respektimin e parimit të gjykimit publik dhe të masave mbrojtëse për dëshmitarët dhe viktimat, Trupi Gjykues e gjykon të arsyeshme të urdhërojë palët dhe Mbrojtësin e Viktimave të rishikojnë transkriptet e seancave gjyqësore që u zhvilluan nga 1 deri më 3 maj 2023 dhe të bëjnë parashtrime, deri më **30 maj 2023**, nëse redaktimet ekzistuese mund të hiqen dhe/ose transkriptet të riklasifikohen si publike.
6. Palët dhe Mbrojtësi i Viktimave duhet të bashkëpunojnë dhe të paraqesin parashtrime të përbashkëta lidhur me heqjen e redaktimeve/riklasifikimin e transkripteve në një parashtrim përmbledhës. Trupi Gjykues u kujton palëve dhe

¹ KSC-BC-2020-04, F00476, Trupi Gjykues I, *Urdhër për Parashtrime në lidhje me Heqjen e Redaktimeve dhe/ose Riklasifikimin e Transkripteve të Seancave Gjyqësore*, 4 prill 2023, publik.

² KSC-BC-2020-04, Transkripti i seancës, 1 maj 2023, konfidencial; Transkripti i seancës, 2 maj 2023, konfidencial; Transkripti i seancës, 3 maj 2023, konfidencial.

Mbrojtësit të Viktimave të sigurojnë që parashtrimet e tyre për heqjen e redaktimeve/riklasifikimin e transkripteve të kenë përputhshmëri brenda çdo transkripti dhe në të gjitha transkriptet.

7. Në rast se palët dhe Mbrojtësi i Viktimave nuk pajtohen në lidhje me pjesë të caktuara të transkriptit, këtë duhet ta specifikojnë në parashtrimet e tyre dhe të paraqesin arsye për mospajtimin e tyre. Në fund, Trupi Gjykses do të vendosë për heqjen e redaktimeve dhe/ose riklasifikimin e transkripteve, në bazë të rregullave 80(1) dhe 84(1) të Rregullores.

8. Gjithashtu, Trupi Gjykses e gjykon të përshtatshme të urdhërojë palët dhe Mbrojtësin e Viktimave të bëjnë të njëjtën gjë në vijimësi, pas përfundimit të çdo blloku dëshmish. Për këtë qëllim dhe duke marrë parasysh kohëzgjatjen eventuale të blloqeve të dëshmive në të ardhmen, palët dhe Mbrojtësi i Viktimave duhet të paraqesin parashtrime të përbashkëta, sikurse vihet në dukje më lart,³ brenda dy javësh nga përfundimi i çdo blloku të ardhshëm dëshmish.⁴ Trupi Gjykses do të vendosë në një fazë të mëvonshme nëse vazhdon të jetë i nevojshëm rishikimi i mëtejshëm i transkripteve në fund të paraqitjes së provave nga secila prej palëve dhe nga Mbrojtësi i Viktimave, në pajtim me rregullat 114 dhe 127 të Rregullores.⁵ E njëjta gjë vlen edhe në rast se Trupi Gjykses vendos të thërrasë dëshmi në pajtim me rregullën 132 të Rregullores.

9. Së fundi, Trupi Gjykses sqaron se, për qëllimet e paragrafit 8, dëshmia e W04887-ës, e planifikuar të dëgjohet më 16 qershor 2023, do të konsiderohet pjesë e bllokut të tretë të dëshmive. Rrjedhimisht, afati për parashtrimet lidhur me bllokun e tretë të

³ *Shih* para. 6-7 më lart.

⁴ Kjo vlen për të gjitha blloqet e ardhshme të dëshmive, qoftë nëse janë planifikuar deri në këtë moment apo jo.

⁵ *Shih* KSC-BC-2020-04, F00434/RED, Trupi Gjykses I, *Versioni i redaktuar publik i Vendimit për Zhvillimin e Gjykimit*, 24 shkurt 2023, publik, para. 76-81.

dëshmime do të fillojë të llogaritet pas përfundimit të dëshmisë së W04887-ës më 16 qershor 2023.

10. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykues:

- a) **URDHËRON** palët dhe Mbrojtësin e Viktimave të paraqesin parashtrime, sikurse vihet në dukje në paragrafët 5-7 të këtij urdhri, deri të **martën, 30 maj 2023**; dhe
- b) **URDHËRON** palët dhe Mbrojtësin e Viktimave të paraqesin parashtrime, sikurse përcaktohet në paragrafët 6-9 të këtij urdhri, brenda dy javësh nga përfundimi i çdo blloku të ardhshëm dëshmish.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Mapi Feld-Folia
Kryegjykatëse

/nënshkrimi/

Gjykatës Zhilber Biti

/nënshkrimi/

Gjykatës Roland Dekers

E hënë, 15 maj 2023

Në Hagë, Holadë.